



Ref.: 1216/25, Datë: 15.10.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Ua 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 142 të mbajtur më datë 29.09.2025, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

VENDIM

I. Nuk riakreditohet programi i studimeve në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë.

- *Edukim Fillor, BA 240 ECTS (R).*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Edukim Fillor, BA 240 ECTS (R).</i>	Zamira Gashi Shatri Venera Vala Këndusi Edita Haxhijaha Ruzhdi Kadrija

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master (tutje Manualit).

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Edukim Fillor, BA 240 ECTS, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit sipas SVP është organizuar me datë 04.02.2025 vizita e I-rë e ekspertëve dhe 25.07.2025 rivlerësimi i programit - vizita e II-të.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë gjatë vizitës për vlerësim ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Nuk e përmbushë fare kriterin **Fusha Standarde 3 lidhur me Stafin Akademik.**

Sipas Rregullores (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master, neni 9, paragrafi 4, thuhet, citojmë: *“Standardet për vlerësimin e programeve të studimit Baqelor dhe Master, Fusha Standarde 3 lidhur me Stafin Akademik, dhe Fusha Standarde 7 lidhur me Infrastrukturën dhe Burimet janë të detyrueshme. Në kuadër të Fushës Standarde 3, standardi 3.2 është i detyrueshëm gjithashtu. Asnjë akreditim i programeve në nivelin Baqelor apo Master nuk mund të jepet përveç nëse të dyja standardet e sipërpërmendura janë përmbushur qoftë në nivel substancial apo në nivel plotësisht në përputhje.”*

Rrjedhimisht, KShC refuzon akreditimin e programit në të gjitha rastet kur programi nuk e përmbush njërin nga kriteret e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 9 të Rregullores (AKA) Nr. 04/2024.

Bazuar në faktet e prezentuara, raportin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, programi *Edukim Fillor, BA 240 ECTS*, nuk i përmbush standardet e kërkuara për akreditim pasi që nuk e përmbushë Fushën 3 që ka të bëjë me stafin akademik.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen 142 të mbajtur më datë 29.09.2025 dhe 08.10.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant dhe bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe rekomandimet përfundimtare të ekspertëve të dhëna në raport për programin *Edukim Fillor, BA 240 ECTS* të Universitetit “Fehmi Agani”, dispozitat ligjore dhe kompetencat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë